**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**BASHKIA POGRADEC**
**KËSHILLI**

**Komisioni I Financave, Buxhetit, Pasurive Bashkiake, Planifikimit të Zhvillimit Strategjik te Bashkise,Mbikeqyrjes Financiare,I Ekonomise Vendore, Turzimit dhe Zhvillimit Rural.**

**Komisioni i Mirëqënies Sociale, Rinisë, Barazisë Gjinore, Mosdiskriminimit, të Drejtave të Njeriut, Marrëdhëniet me jashtë dhe Integrimin Europian**

**Raport vendimmarrjeje**

Nr 1 /Datë 26.08 2025

Lënda: Mendim/vendim i Komisionit për projektvendimin

**"PER DHËNIEN E NDIHMËS EKONOMIKE NGA FONDI 6% E FONDIT TË KUSHTËZUAR PËR BLLOK-NDIHMËN EKONOMIKE, PËR MUAJIN Korrik 2025"** shoqëruar nga relacioni dhe dokumentet shoqëruese.

**Analiza ligjore:**

Në mbështetje të nenit 8, pika 2,nenit 9,pika 1/1,1,shkronja (a) dhe (b),nenit 55,pikat 2 dhe 6 të ligjit nr.139/2015"Për vetëqeverisjen vendore";nenit 21 të ligjit nr.57/2019,"Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë",vendimit nr.597,datë 4.09.2019 të Këshillit të Ministrave"Për përcaktimin e proçedurave,të dokumentacionit dhe masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike",Vendimit të Këshillit Bashkiak Pogradec Nr.3 datë 27.01.2025, "Për miratimin e kritereve të familjeve në nevojë që do të trajtohen me fondin deri në 6% nga fondi i kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike" me kërkesë të Kryetarit të Bashkisë Kolonjë,

**Situata aktuale e funksionit:**

Familjet në nevojë që janë rekomanduar nga administratorët shoqërorë të ndihmës ekonomike , janë përzgjedhur nga lista e familjeve që kanë aplikuar nëpërmjet Regjistrit Elektronik Kombëtar për ndihmë ekonomike dhe nuk janë shpallur përfitues nga sistemi i pikëzimt.Kjo listë del në fund të muajit .Administratorët shoqërorë kanë kryer paraprakisht vlerësimin social-ekonomik dhe kanë përzgjedhur familjet që plotësojnë kriteret për tu trajtuar nga fondi 6% i bllok-ndihmës ekonomike.

Nga dokumentacioni i paraqitur, si dhe nga verifikimet e kryera nga administratorët shoqërorë të njësive përkatse, konkludohet dhe propozimet:
Të trajtohen me ndihmë ekonomike nga fondi 6% i fondit të kushtëzuar të ndihmës ekonomike për muajin Korrik 2025 gjithsej 167 familje me fond 711485 Leke.

**Situata financiare:**
Sipas dokumentacionit/relacionit qe shoqeron projekt vendimin

**Drejtoria/Sektori përgjegjës:**

Drejtoria e sherbimeve sociale

Drejtoria e Financës

**Monitorimi dhe raportimi:**

Drejtoria e sherbimeve sociale

*Keshilli bashkiak Pogradec*

**Impakti social/grupet qe preken:**

*Qytetare te bashkise Pogradec*

**A është objekt i konsult**

**imit publik?**

*Jo.*

Komisioni I Financave, Buxhetit, Pasurive Bashkiake, Planifikimit të Zhvillimit Strategjik te Bashkise,Mbikeqyrjes Financiare,I Ekonomise Vendore, Turzimit dhe Zhvillimit Rural. Komisioni i Mirëqënies Sociale, Rinisë, Barazisë Gjinore, Mosdiskriminimit,të Drejtave të Njeriut, Marrëdhëniet me jashtë dhe Integrimin Europian, i mbledhur më datë 26.08 2025, shqyrtoi projektvendimin **"PER DHËNIEN E NDIHMËS EKONOMIKE NGA FONDI 6% E FONDIT TË KUSHTËZUAR PËR BLLOK-NDIHMËN EKONOMIKE, PËR MUAJIN Korrik 2025".** Pas shqyrtimit të projektvendimit dhe materialeve shoqëruese, komisioni me shumicë votash, vendosi:

**T'i propozojë Keshillit bashkiak:**

- *a- (Miratimin e projektaktit.*
- *b- Kalimin e projektaktit në mbledhjen e Këshillit për vlerësimin e mëtejshëm dhe për shqyrtim.*
- *c- Refuzimin e miratimit te projektaktit.*
- *d- Miratimin e projektaktit me ndryshimet si më poshtë:)*

____________________________________________

____________________________________________

____________________________________________

Bashkëlidhur argumentet e vendimmarrjes dhe mendimi i pakicës i paraqitur në procesverbalin e mbledhjes se komisionit.

Celnik Hasthollari __________ **Kryetar i komisionit**

*(emri, mbiemri, firma)*

Mimoza Sheli __________ **Sekretar i komisionit**

*(emri, mbiemri, firma)*

Datë: 26.08 2025

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**BASHKIA POGRADEC**
**KËSHILLI**

**Komisioni I Arsimit , Sporteve dhe Clodhje, I Kultures, Trashegimise Kulturore, Dhenies se Titujve dhe Emertimeve**

**Raport vendimmarrjeje**

Nr 2 /Datë 26.08 2025

Lënda: Mendim/vendim i Komisionit për projektvendimin

**"MIRATIMIN E RINOVIMIT TË KONTRATAVE TË QIRASË PËR AMBIENTE ARSIMORE NË BASHKINË POGRADEC PËR VITIN SHKOLLOR 2025-2026"**shoqëruar nga relacioni dhe dokumentet shoqëruese.

**Analiza ligjore:**

Në mbështetje të të pikës 2 të nenit 8, shkronjës "a", dhe "c", të nënpikës 1.2 të nenit 9, në pikën 12 të nenit 23, nenit 54 shkronja "k", nenit 55, pika 2 dhe 6, të Ligjit Nr.139, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar, nenit 21, 22, nenit 28, pikat 1 dhe 2, të ligjit nr. 69/2012, "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, Ligjit Nr.10926, datë 08.07.2011, "Per menaxhimin financiar dhe kontrollin" i ndryshuar, në nenin 801 e vijues të Ligjit Nr. 7850, datë 29.7.1994, "Për Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar, Ligjit nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë", vendimit nr. 621, date 22.10.2021 "Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Arsimin 2021–2026 dhe të planit të veprimit për zbatimin e saj", vendimi nr. 659, datë 03.11.2021, të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e Agjendës Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve 2021- 2026", në zbatim të Vendimit të Këshillit Bashkiak Pogradec nr.90, datë 29.08.2024, si dhe mbështetur tek Relacionet shpjeguese të Qëndrës Arsimore dhe Kërkesat e Administratorëve të Njësive Administrative,

**Situata aktuale e funksionit:**

Argumenti më i fortë në favor të këtij propozimi është mbrojtja e të drejtës kushtetuese të fëmijëve për arsim. Legjislacioni shqiptar, si dhe standardet ndërkombëtare, garantojnë qasjen e barabartë në arsimin parashkollor dhe fillor. Në tre rastet e paraqitura – në fshatin Selcë e Poshtme, Buzaishtë dhe Stropckë – strukturat publike arsimore janë ose jashtë standardeve, ose të rrënuara, ose nuk ekzistojnë më.

Rinovimi i kontratave të qirasë shërben si zgjidhja e vetme dhe imediate për të shmangur ndërprerjen e procesit mësimor për një numër të konsiderueshëm fëmijësh. Kjo masë e përkohshme siguron që arsimi të vazhdojë pa vonesa, duke adresuar një problem kritik të identifikuar nga administratorët e njësive administrative dhe drejtuesëve.

**Situata financiare:**

Sipas dokumentacionit/relacionit qe shoqeron projekt vendimin

**Drejtoria/Sektori përgjegjës:** Qendra Arsimore pranë Bashkisë Pogradec

**Monitorimi dhe raportimi:**

Qendra Arsimore pranë Bashkisë Pogradec

*Keshilli bashkiak Pogradec*

**Impakti social/grupet qe preken:**

*Qytetare te bashkise Pogradec*

**A është objekt i konsultimit publik?**

*Jo*

Komisioni I Arsimit , Sporteve dhe Clodhje, I Kultures, Trashegimise Kulturore, Dhenies se Titujve dhe Emertimeve, i mbledhur më datë 26.08 2025, shqyrtoi projektvendimin **"PER MIRATIMIN E RINOVIMIT TË KONTRATAVE TË QIRASË PËR AMBIENTE ARSIMORE NË BASHKINË POGRADEC PËR VITIN SHKOLLOR 2025-2026".** Pas shqyrtimit të projektvendimit dhe materialeve shoqëruese, komisioni me shumicë votash, vendosi:

**T'i propozojë Keshillit bashkiak:**

*a- (Miratimin e projektaktit.*
*b- Kalimin e projektaktit në mbledhjen e Këshillit për vlerësimin e mëtejshëm dhe për shqyrtim.*
*c- Refuzimin e miratimit te projektaktit.*
*d- Miratimin e projektaktit me ndryshimet si më poshtë:)*

______________________________________________________________

______________________________________________________________

______________________________________________________________

Bashkëlidhur argumentet e vendimmarrjes dhe mendimi i pakicës i paraqitur në procesverbalin e mbledhjes se komisionit.

Luri Seidlani __________ **Kryetar i komisionit**

*(emri, mbiemri, firma)*

Elsona Turshena __________ **Sekretar i komisionit**

*(emri, mbiemri, firma)*

Datë: 26.08 2025

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**BASHKIA POGRADEC**
**KËSHILLI**

**Komisioni i Sigurisë Publike, Emergjencave Civile, Rehabilitimit, Qeverisë Elektronike dhe Teknologjisë së Informacionit**
**Komisioni i Financave, Buxhetit, Pasurive Bashkiake, Planifikimit, Zhvillimit Strategjik të Bashkisë,Mbikeqyrjes Financiare, Ekonomisë Vendore, Turizimit dhe Zhvillimit Rural**

**Raport vendimmarrjeje**

Nr___3___/Datë_26.08_2025

Lënda: Mendim/vendim i Komisionit për projektvendimin

**"PËR AKORDIMIN E NDIHMËS FINANCIARE Z. Lavdimir Biba, Fshati Buzaisht, NJA Velcan, Bashkia Pogradec, per humbjen e jetes si pasoje e renies se rrufese."** shoqëruar nga relacioni dhe dokumentet shoqëruese.

**Analiza ligjore:**

Në mbështetje të pikës 2 të nenit 8, të pikës 1 të nenit 29, të ligjit nr. 139/2015, "Për Veteqeverisjen Vendore", të neneve 4, 7 dhe 41, të ligjit nr. 45/2019, datë 18.07.2019 "Për Mbrojtjen Civile" dhe të kapitullit III të V.K.M Nr. 329, datë 16.05.2012 "Për kriteret dhe proçedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerezore", me propozim të Kryetarit të Bashkisë:

**Situata aktuale e funksionit:**

Miratimi i kërkesës së Bashkisë Pogradec për mbështetje financiare të familjes se Z. Lavdimir Biba, Fshati Buzaisht, NJA Velcan, Bashkia Pogradec, I cili humbi jeten si pasoje e renies se rrufese ne daten 04.08.2025.

**Situata financiare:**
Sipas dokumentacionit/relacionit qe shoqeron projekt vendimin

**Drejtoria/Sektori përgjegjës:**

Drejtoria e Emergjencave, Strehimit dhe Administrimit të Tokës Bujqësore në Njësitë Administrative dhe Shërbimeve

Drejtoria e administrimit te ceshtjeve ekonomike dhe finaniare te bashkise Pogradec.

**Monitorimi dhe raportimi:**

Drejtoria e Emergjencave, Strehimit dhe Administrimit të Tokës Bujqësore në Njësitë Administrative dhe Shërbimeve

Drejtoria e administrimit te ceshtjeve ekonomike dhe finaniare te bashkise Pogradec

*Keshilli bashkiak Pogradec*

**Impakti social/grupet qe preken:**

*Familja e Z. Lavdimir Biba*

**A është objekt i konsultimit publik?**

*Jo.*

Komisioni i Sigurisë Publike, Emergjencave Civile, Rehabilitimit, Qeverisë Elektronike dhe Teknologjisë së Informacionit, Komisioni i Financave, Buxhetit, Pasurive Bashkiake, Planifikimit, Zhvillimit Strategjik të Bashkisë, Komisioni I Mbikeqyrjes Financiare, Ekonomisë Vendore, Turizimit dhe Zhvillimit Rural, i mbledhur më datë 26.08 2025, shqyrtoi projektvendimin

**"PËR AKORDIMIN E NDIHMËS FINANCIARE Z. Lavdimir Biba, Fshati Buzaisht, NJA Velcan, Bashkia Pogradec, per humbjen e jetes si pasoje e renies se rrufese.",** Pas shqyrtimit të projektvendimit dhe materialeve shoqëruese, komisioni me shumicë votash, vendosi:

**T'i propozojë Keshillit bashkiak:**

a- *(Miratimin e projektaktit.*
b- *Kalimin e projektaktit në mbledhjen e Këshillit për vlerësimin e mëtejshëm dhe për shqyrtim.*
c- *Refuzimin e miratimit te projektaktit.*
d- *Miratimin e projektaktit me ndryshimet si më poshtë:)*

________________________________________

________________________________________

Bashkëlidhur argumentet e vendimmarrjes dhe mendimi i pakicës i paraqitur në procesverbalin e mbledhjes se komisionit.

Odhise Mihallari ________ **Kryetar i komisionit**

*(emri, mbiemri, firma)*

Mayeda Biba ________ **Sekretar i komisionit**

*(emri, mbiemri, firma)*

Datë: 26.08 ________ 2025

**R E P U B L I K A E S H Q I P Ë R I S Ë**
**BASHKIA POGRADEC**
**KËSHILLI**

**Komisioni I Mandateve, Rregulloreve, Ceshtjeve Juridike, Qeverisjes se Mire, Administrates,Zgjedhjeve, Strukturave Komunitare, I Etikes, Konflitit te Interesit, Standarteve dhe Apelimeve**

**Raport vendimmarrjeje**

Nr 4 /Datë 26.08 2025

Lënda: Mendim/vendim i Komisionit për projektvendimin

**"PËR**

**MIRATIMIN E PROJEKTMARRËVESHJES PËR KRIJIMIN E PERSONIT JURIDIK SI SUBJEKT I KOMPETENCAVE TË PËRBASHKËTA MIDIS NJËSIVE TË VETËQEVERISJES VENDORE DHE KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË PËR RRITJEN E KAPACITETEVE TE QEVERISJES VENDORE, AKADEMIA E TRAJNIMIT TË NJËSIVE TË VETËQEVERISJES VENDORE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË (TALGA)"** shoqëruar nga relacioni dhe dokumentet shoqëruese.

**Analiza ligjore:**

Në mbështetje të nenit 2, pika11, nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronja "b" dhe nënpika 1.6, shkronja "b", nenit 14 pika 5, neni 51 pika 4, nenit 54, shkronja "d" dhe "gj", nenit 55 pikat 3, neni 64 shkronja "h", të Ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore" (i ndryshuar), Ligjit Nr. 8548, datë 11.11.1999 "Për ratifikimin e Kartës Evropiane të Autonomisë Vendore", Ligjit nr. 8788, datë 07.05.2001 "Për organizatat jofitimprurëse" (i ndryshuar), Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 405, datë 16.07.2025 "Për autorizimin e ministrit përgjegjës për cështjet vendore për negocimin dhe nënshkrimin e marrëveshjes me njësitë e vetëqeverisjes vendore për krijimin në krijimin e personit juridik si subjekt i kompetencave të përbashkëta me vetëqeverisjen vendore për rritjen e kapaciteteve të qeverisjes vendore të Republikës së Shqipërisë", me propozim të Kryetarit të Bashkisë,

**Situata aktuale e funksionit:**

TALGA do të ketë si mision zhvillimin dhe kualifikimin profesional të qëndrueshëm të të zgjedhurve, nëpunësve civilë dhe punonjësve të tjerë të njësive të vetëqeverisjes vendore, përfshirë punonjësit e institucioneve dhe ndërmarrjeve në varësi, me qëllim rritjen e performancës profesionale të tyre për t'i shërbyer cilësisht komuniteteve, për të përmbushur funksionet dhe kompetencat ligjore të njësive të vetëqeverisjes vendore (NJVV), si dhe për të përballuar me sukses sfidat e NJVV-ve në procesin e integrimit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian. Në kuadër të misionit të saj TALGA bën vlerësim të nevojave për trajnim, harton programe trajnimi dhe planet e trajnimeve, administron dhënjen e trajnimeve të vazhdueshme dhe të tjera, përcakton kriteret dhe bën përzgjedhjen e pjesëmarrësve në trajnime, krijon rrjetet e zyrtarëve vendorë për shpërndarjen e njohurive dhe praktikave të mira, administron një platformë të menaxhimit dhe ndarjes së njohurive për zyrtarët e NJVV-ve dhe të interesuar në sektorin e qeverisjes vendore, harton dhe zbaton projekte dhe aktivitetet në fushën e veprimtarisë së TALGA, ofron ekspertizë dhe shërbime konsulence ndaj NJVV-ve, bashkëpunon me organizata homologe dhe partnerë të ndryshëm për realizimin emisionit të saj, kryen studime dhe zhvillon dokumente politikash në fushën e zhvillimit të kapaciteteve të zyrtarëve të NJVV-ve.

**Situata financiare:**
Sipas dokumentacionit/relacionit qe shoqeron projekt vendimin

**Drejtoria/Sektori përgjegjës:**

Kryetari Bashkisë,

Drejtoria e ceshtjeve juridike dhe prokurimeve publike.

Drejtoria e Ekonomisë dhe Menaxhimit Financiar të Bashkisë Pogradec,

**Monitorimi dhe raportimi:**

Drejtoria e ceshtjeve juridike dhe prokurimeve publike.

Drejtoria e Ekonomisë dhe Menaxhimit Financiar

*Keshilli bashkiak Pogradec*

**Impakti social/grupet qe preken:**

*Bashkia Pogradec*

**A është objekt i konsult**

**imit publik?**

*Jo*

Komisioni I Mandateve, Rregulloreve, Ceshtjeve Juridike, Qeverisjes se Mire, Administrates,Zgjedhjeve, Strukturave Komunitare, I Etikes, Konflitit te Interesit, Standarteve dhe Apelimeve, i mbledhur më datë 26.08 2025, shqyrtoi projektvendimin **"PËR MIRATIMIN E PROJEKTMARRËVESHJES PËR KRIJIMIN E PERSONIT JURIDIK SI SUBJEKT I KOMPETENCAVE TË PËRBASHKËTA MIDIS NJËSIVE TË VETËQEVERISJES VENDORE DHE KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË PËR RRITJEN E KAPACITETEVE TE QEVERISJES VENDORE, AKADEMIA E TRAJNIMIT TË NJËSIVE TË VETËQEVERISJES VENDORE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË (TALGA)".** Pas shqyrtimit të projektvendimit dhe materialeve shoqëruese, komisioni me shumicë votash, vendosi:

**T'i propozojë Keshillit bashkiak:**

*a- (Miratimin e projektaktit.*
*b- Kalimin e projektaktit në mbledhjen e Këshillit për vlerësimin e mëtejshëm dhe për shqyrtim.*
*c- Refuzimin e miratimit te projektaktit.*
*d- Miratimin e projektaktit me ndryshimet si më poshtë:)*

________________________________________________

________________________________________________

________________________________________________

Bashkëlidhur argumentet e vendimmarrjes dhe mendimi i pakicës i paraqitur në procesverbalin e mbledhjes se komisionit.

Klea Topa **Kryetar i komisionit**

*(emri, mbiemri, firma)*

Brunilda Gora **Sekretar i komisionit**

*(emri, mbiemri, firma)*

Datë: 26.08 2025

**R E P U B L I K A   E   S H Q I P Ë R I S Ë**
**BASHKIA POGRADEC**
**KËSHILLI**

**Komisioni i Mirëqënies Sociale, Rinisë, Barazisë Gjinore, Mosdiskriminimit, të Drejtave të Njeriut, Marrëdhëniet me jashtë dhe Integrimin Europian**

**Komisioni I Financave, Buxhetit, Pasurive Bashkiake, Planifikimit të Zhvillimit Strategjik te Bashkise,Mbikeqyrjes Financiare,I Ekonomise Vendore, Turzimit dhe Zhvillimit Rural.**

**Raport vendimmarrjeje**

Nr 5 /Datë 26.03. 2025

Lënda: Mendim/vendim i Komisionit për projektvendimin

**"PËR MIRATIMIN E PLANIT VENDOR TË VEPRIMIT PËR BARAZINË GJINORE 2025 – 2030 TË BASHKISË POGRADEC"**shoqëruar nga relacioni dhe dokumentet shoqëruese.

**Analiza ligjore:**

Në mbështetje të nenit 8 pika 2, nenin 9 pika 1/1.1 gërma "b", neni 24 pika 1, nenin 54 gërma "k", neni 55 pikat 2 dhe 6 të Ligjit 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", i ndryshuar, Ligjit nr. 9970, datë 24.7.2008 "Për barazinë gjinore në shoqëri" neni 14; Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 400, datë 30.6.2021 "Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Barazinë Gjinore, 2021 - 2030 dhe të planit të saj të veprimit"; Ligjit Nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", i ndryshuar, Ligjit Nr. 9669, datë 18.12.2006 "Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare", i ndryshuar; Ligjit Nr. 10221 datë 4.2.2010 "Për mbrojtjen nga diskriminimi", i ndryshuar; Kartës Evropiane për Barazi të Grave dhe Burrave në Jetën Vendore, nënshkruar nga Bashkia Pogradec më 28.05.2020; Urdhërit të Kryetarit nr.18, datë 27.01.2025 "Për krijimin e grupit të punës për hartimin e Planit Vendor të Veprimit për Barazinë Gjinore (PVVBGJ)", si dhe relacionit të përgatitur nga Drejtoria e Shërbimeve Sociale, Bashkia Pogradec, me propozim të Kryetarit të Bashkisë,

**Situata aktuale e funksionit:**

Qëllimi i këtij plani është të shërbejë si mjet kryesor për zbatimin e angazhimeve publike për barazinë gjinore, të ndërmarra nëpërmjet nënshkrimit të Kartës Evropiane për Barazi të Grave dhe Burrave në Jetën Vendore, si dhë në përputhje dhe zbatim të Strategjisë Kombëtare për Barazinë Gjinore 2021 – 2030", por edhe si një dokument që mundëson harmonizimin e veprimeve vendore me acquis të BE-së për barazinë gjinore, në rrugëtimin tonë si bashki, drejt integrimit evropian.

Ky dokument, i përgatitur nga Bashkia Pogradec përmes një procesi konsultues gjithëpërfshirës, ka të përcaktuar qartë vizionin, fushat kryesore të ndërhyrjes, rezultatet e pritshme, objektivat specifikë, treguesit, si dhe masat e veprimet që duhet të ndërmerren në këto vite për të përparuar drejt barazisë gjinore, si kusht për një zhvillim të qëndrueshëm.

I gjithë procesi u mbështet nga UN Women Shqipëri në kuadër të Projektit "Bashkimi Evropian për Barazinë Gjinore II - Instrumenti i Lehtësimit të Barazisë Gjinore në Shqipëri" (EU4GE II), që financohet nga Bashkimi Evropian.

**Situata financiare:**
Sipas dokumentacionit/relacionit qe shoqeron projekt vendimin

**Drejtoria/Sektori përgjegjës:** Drejtoria e Shërbimeve Sociale, Drejtoria Ekonomike dhe e Menaxhimit Financiar, si dhe drejtori të tjera përgjegjëse sipas nevojës, Bashkia Pogradec.

**Monitorimi dhe raportimi:**

Drejtoria e Shërbimeve Sociale, Drejtoria e Ekonomisë dhe Menaxhimit Financiar *Keshilli bashkiak Pogradec*

**Impakti social/grupet qe preken:**

*Qytetare te bashkise Pogradec*

**A është objekt i konsultimit publik?**

*Po, realizuar konsultimi publik*

Komisioni i Mirëqënies Sociale, Rinisë, Barazisë Gjinore, Mosdiskriminimit, të Drejtave të Njeriut, Marrëdhëniet me jashtë dhe Integrimin Europian

Komisioni I Financave, Buxhetit, Pasurive Bashkiake, Planifikimit të Zhvillimit Strategjik te Bashkise,Mbikeqyrjes Financiare,I Ekonomise Vendore, Turzimit dhe Zhvillimit Rural, i mbledhur më datë 26-08 2025, shqyrtoi projektvendimin **"PËR MIRATIMIN E PLANIT VENDOR TË VEPRIMIT PËR BARAZINË GJINORE 2025 – 2030 TË BASHKISË POGRADEC"** Pas shqyrtimit të projektvendimit dhe materialeve shoqëruese, komisioni me shumicë votash, vendosi:

**T'i propozojë Keshillit bashkiak:**

a- (Miratimin e projektaktit.
b- Kalimin e projektaktit në mbledhjen e Këshillit për vlerësimin e mëtejshëm dhe për shqyrtim.
c- Refuzimin e miratimit te projektaktit.
d- Miratimin e projektaktit me ndryshimet si më poshtë:)

______________________________________________

______________________________________________

______________________________________________

Bashkëlidhur argumentet e vendimmarrjes dhe mendimi i pakicës i paraqitur në procesverbalin e mbledhjes se komisionit.

Mimoza Shuli ______________ **Kryetar i komisionit**

*(emri, mbiemri, firma)*

Arber Male. ______________ **Sekretar i komisionit**

*(emri, mbiemri, firma)*

Datë: 26.08.2025 ______ 2025

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
KËSHILLI

**Komisioni i Mandateve, Rregulloreve, Çështjeve Juridike, Qeverisjes së Mirë, Administratës,**

**Raport vendimmarrjeje**

Nr 6 /Datë 26.08 2025

Lënda: Mendim/vendim i Komisionit për projektvendimin

**PER MIRATIMIN NË PARIM TË DHËNIES ME QIRA, NË FAVOR TE INDIVIDEVE KËRKUES PËR NDERTIM FOTOVOLTAIKE (STACIONET, BAZAMENTET DHE OBJEKTET PËRKATËSE ETJ.), TË PASURISË ME SIPËRFAQE TOTALE 303259 M2 (Treqind e tremije e dyqind e pesedhjete e nentemije ) M2.**

shoqëruar nga relacioni dhe dokumentet shoqëruese.

1. **Analiza ligjore:** Në mbështetje të; pikës 2 të nenit 8, pikës 1.2 gërma "a" të nenit 9, pikës 5 të nenit 27, dhe gërmës "e" të nenit 54 të Ligjit Nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen Vendore", i ndryshuar, Ligjit Nr. 44/2015, "Kodi i Proçedurave Administrative i Republikës së Shqipërise", Kreun VI të Ligjit Nr.7850, datë 29.7.1994 "Kodi Civil i Republikes se Shqiperise", i ndryshuar, Ligjit Nr.8744, datë 22.02.2001 "Për transferimin e pronave te paluajteshme publike te shtetit në njësitë e qeverisjes vendore ", të ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.816, datë 04.06.2008 "Për miratimin e listes së inventarit të pronave të paluajtëshme shtetërore pyje e kullota në Komunën Çërravë, të Qarkut të Korçës", i ndryshuar me VKM nr. 398, datë 19/05/2020 "Për disa ndryshime ne vendimin nr.433, date 08.06.2016, të Keshillit të Ministrave, "Për transferimin në pronesi te bashkive te pyjeve dhe kullotave publike sipas listave te inventarit dhe aktualisht ne administrim te Ministrise se Mjedisit e te ish – Komunave /Bashkive", si dhe Vendimit te Keshillit te Ministrave, Udhëzimi nr. 1, datë 09/06/2016, "Për rregullat, procedurat e kërkimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullosor publik" dhe sipas tarifave të përcaktuara nga Vendimi i Këshillit të Ministrave, Nr. 559, datë 29.07.2022 " Per percaktimin e çmimeve dhe tarifave per dhenien ne shfrytezim/perdorim te fondit pyjor kombetar, per veprimtarive ekonomike, si dhe per prodhimet drusore dhe jodrusore pyjore ", me propozim të Kryetarit të Bashkisë,, Këshilli Bashkiak:

**Situata aktuale e funksionit:**

Sektori i Trajtimit të Titujve të Pronësisë dhe Shpronësimeve, Bashkia Pogradec, ka marrë evidentuar pronen me nr 30/2, 32, 35 dhe 66 Zk 1387 qe mund te jete nje prone qe mund te zhvillohet nga individe te ndryshem per qellimin e cituar me lart, për vete pozicjonimin dhe vendosjen e kesaj prone mabsi eshte larg nga qendrat e banuar dhe pa ndikime ne mjedis.

Nga analiza dhe interesimi i disa individeve dhe pozicionin e pasurise propozojme dhenien me qera te siperfaqes prej 30,3259 ha siperfaqe e cila sipas llojit te qeverisjes se pyjeve sipas planit te mbareshtrimit te ish komunes Cerrave eshte kullote ne vendin e quajtur Çërravë si dhe nga verifikimi ne vend dolen me keto konkluzione:
Sipas VKM nr. 398, datë 19/05/2020 "Për disa ndryshime ne vendimin nr.433, date 08.06.2016, të Keshillit të Ministrave, "Për transferimin në pronesi te bashkive te pyjeve dhe kullotave publike sipas listave te inventarit dhe aktualisht ne administrim te Ministrise se Mjedisit e te ish – Komunave /Bashkive", pasuria 30/2, 32, 35 dhe 66 Zk 1387, që është pjesë e ngastrave kullosore te Ekonomise Kullosore Pretushe -Lin kalon ne pronesi Bashkise Pogradec.

Siperfaqia e kerkuar ndodhet , ne kufirin ndermjet Fshatrave Çërravë dhe Lumas ne nje largesi te konsiderueshme nga qendrat e banuara, dhe tradicionalisht ka qene pjese e fshatit Çërravë.

Ne referim te bazes ligjore te sipercituar, ky proces te kryhet sipas percaktimeve te Udhëzimi nr. 1, datë 09/06/2016, "Për rregullat, procedurat e kërkimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullosor publik" dhe sipas tarifave të përcaktuara nga Vendimi i Këshillit të Ministrave, Nr. 559, datë 29.07.2022 " Per percaktimin e çmimeve dhe tarifave per dhenien ne shfrytezim/perdorim te fondit pyjor kombetar, per veprimtarive ekonomike, si dhe per prodhimet drusore dhe jodrusore pyjore "

Tarifat për dhënien në përdorim/qera të ketyre pasurive, të aplikohen sipas pikes "8", te shtojces nr 1 të Vendimit Nr. 559, datë 29.07.2022 te Keshillit te Ministrave "Për percaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhenien ne Shfrytezim/ perdorim te fondit pyjor kombetar, per veprimtari ekonomike, si dhe per prodhimet drusore dhe jodrusore pyjore.

Perfundimisht, per sa me siper, Në zbatim të nenit 54, shkronja "e" të Ligjit Nr. 139, datë 17.12 2014 "Për veteqeverisjen vendore", citohet se: ***"Këshilli bashkiak, ndër të tjera, e) miraton tjetërsimin ose dhënien në përdorim të pronave të tretëve".***

**Drejtoria/Sektori përgjegjës:**

Administrata e bashkise Pogradec

**Monitorimi dhe raportimi:**

Administrata e bashkise Pogradec

*Keshilli bashkiak Pogradec*

**Impakti social/grupet qe preken:**

*Qytetare te bashkise Pogradec,*

**A është objekt i konsultimit publik?**

Po, realizuar konsultimi publik

Komisioni i Mandateve, Rregulloreve, Çështjeve Juridike, Qeverisjes së Mirë, Administratës, i mbledhur më datë 26.08 2025, shqyrtoi projektvendimin : **PER MIRATIMIN NË PARIM TË DHËNIES ME QIRA, NË FAVOR TE INDIVIDEVE KËRKUES PËR NDERTIM FOTOVOLTAIKE (STACIONET, BAZAMENTET DHE OBJEKTET PËRKATËSE ETJ.), TË PASURISË ME SIPËRFAQE TOTALE 303259 M2 (Treqind e tremije e dyqind e pesedhjete e nentemije ) M2.**

Pas shqyrtimit të projektvendimit dhe materialeve shoqëruese, komisioni me shumicë votash, vendosi:

**T'i propozojë Keshillit bashkiak:**

*a- (Miratimin e projektaktit.*
*b- Kalimin e projektaktit në mbledhjen e Këshillit për vlerësimin e mëtejshëm dhe për shqyrtim.*
*c- Refuzimin e miratimit te projektaktit.*
*d- Miratimin e projektaktit me ndryshimet si më poshtë:)*

________________________________________

________________________________________

Bashkëlidhur argumentet e vendimmarrjes dhe mendimi i pakicës i paraqitur në procesverbalin e mbledhjes se komisionit.

Klea Topa ________ **Kryetar i komisionit**

*(emri, mbiemri, firma)*

Brunelda Gora ________ **Sekretar i komisionit**

*(emri, mbiemri, firma)*

Datë: 26.08.2025

**R E P U B L I K A E S H Q I P Ë R I S Ë**
**BASHKIA POGRADEC**
**KËSHILLI**

**Komisioni i Mandateve, Rregulloreve, Çështjeve Juridike, Qeverisjes së Mirë, Administratës,**

**Raport vendimmarrjeje**

Nr___7___/Datë__26.08__2025

Lënda: Mendim/vendim i Komisionit për projektvendimin

**PËR MIRATIMIN E LISTËS TË SIPËRFAQES SË TOKËS PREJ 35,5200 HA, E NDODHUR NË NJËSINË ADMINISTRATIVE ÇËRRAVË QË MUND TË JEPEN ME QIRA,**

shoqëruar nga relacioni dhe dokumentet shoqëruese.

**Analiza ligjore:** Në mbështetje të nenit 54 të ligjit nr. 139/2015 "Per Vetëqeverisjen Vendore", neni 2 i ligjit nr. 8312, datë 26.03.1998 "Për tokat bujqësore të pandara", Udhëzimin nr. 1, datë 18.07.2012, të Këshillit të Ministrave, "Për procedurat e dhënies me qira të tokave bujqësore të pandara" dhe Udhëzimit nr.2, datë 20.04.2016 "Për shfuqëzimin e udhëzimit nr. 3, datë 27.11.2013, të Këshillit të Ministrave "Për pezullimin e përkohshëm të udhëzimit nr.1, datë 18.07.2012, të Këshillit të Ministrave "Për procedurat e dhënies me qira të tokave bujqësore të pandara" me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli i Bashkisë,

**Situata aktuale e funksionit:**

këto sipërfaqe toke **i kanë kaluar në pronësi** ish Komunes Çërravë me Vendimin e Keshillit te Ministrave Nr 417, datë 08/06/2011 "Për miratimin e listës perfundimatre të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Komunës Çërrave, të qarkut të Korçës",
Gjithashtu theksojmë faktin se në zbatim të V.K.M-së nr. 510, datë 10.6.2015 " Për miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiveve të trupëzuara dhe të patrupëzuara, të arkivave dhe çdo dokumentacioni tjetër zyrtar në njësitë e qeverisjes vendore, të prekura nga riorganizimi administrativo-territorial" të gjitha të drejtat e pronësisë që iu takonin ish- Komunave tani i takojnë Bashkisë Pogradec.

Në këto kushte dhe bazuar në nënin 54 gërma “e” të ligjit 139/2015 “Per vetëqeverisjen vendore”, nr. 531, datë 21.08.1998 "Për tokat bujqësore të pandara" i ndryshuar dhe Udhëzimin nr. 1, datë 18.07.2012, të Këshillit të Ministrave, "Për procedurat e dhënies me qera të tokave bujqësore të pandara" dhe Udhëzimit nr.2, datë 20.04.2016 "Për shfuqëzimin e udhëzimit nr. 3, datë 27.11.2013, të Këshillit të Ministrave, "Për pezullimin e përkohshëm të udhëzimit nr.1, datë 18.07.2012 , të Këshillit të Ministrave, "Për procedurat e dhënies me qera të tokave bujqësore të pandara" i propozojmë Këshillit Bashkiak të miratojë listën dhe sipërfaqet përkatëse të parcelave që mund të jepen me qera , të ndodhur në Njësinë Administrative Çërravë sipas tabelës dhe sasisë totale te pasqyruar ne projektvendim

Në referim të bazës ligjore nga Drejtoria e emergjencave, strehimit dhe administrimit tokes bujqesore ne njesite administrative, Sektori trajtimit titujve pronesise dhe shpronesimeve, janë krijuar korrespodencat dhe dokumuntacioni përkatës me Drejtorinë e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës në Qark, Drejtorinë Rajonale të Bujqësisë, Angjesine Shteterore te Kadastres Drejtoria Vendore Pogradec dhe Njësinë Administrative për të zbatuar sa më mirë dhe Udhëzimin e Këshillit të Ministrave për dhënien me qera të këtyre sipërfaqeve dhe zbatimin edhe te urdherave qe ka nxjerre Kryetari i Bashkise per zbatimin sa me te mire dhe transparent te ketij Udhezimi, duke pergatitur shkresat dhe modelet e akteve te verifikimit dhe njoftimet qe njesite administrative kane administruar dhe dhe marre nga ana jone.

**Theksojmë se Bashkia Pogradec është paisur me çertifikatë pronesie dhe me miratimin tuaj do vazhdoje procedura e dhenies me qera nga Bordi i Qeradhenies Tokes Bujqesore te Bashkise Pogradec, dhe sektori perkates.**

**Drejtoria/Sektori përgjegjës:**

Administrata e bashkise Pogradec

**Monitorimi dhe raportimi:**

Administrata e bashkise Pogradec

*Keshilli bashkiak Pogradec*

**Impakti social/grupet qe preken:**

*Qytetare te bashkise Pogradec,*

**A është objekt i konsultimit publik?**

Po, realizuar konsultimi publik

Komisioni i Mandateve, Rregulloreve, Çështjeve Juridike, Qeverisjes së Mirë, Administratës, i mbledhur më datë 26.08 2025, shqyrtoi projektvendimin **PËR MIRATIMIN E LISTËS TË SIPËRFAQES SË TOKËS PREJ 35,5200 HA, E NDODHUR NË NJËSINË ADMINISTRATIVE ÇËRRAVË QË MUND TË JEPEN ME QIRA.**

Pas shqyrtimit të projektvendimit dhe materialeve shoqëruese, komisioni me shumicë votash, vendosi:

**T'i propozojë Keshillit bashkiak:**

a- *(Miratimin e projektaktit.*

b- *Kalimin e projektaktit në mbledhjen e Këshillit për vlerësimin e mëtejshëm dhe për shqyrtim.*

c- *Refuzimin e miratimit te projektaktit.*

d- *Miratimin e projektaktit me ndryshimet si më poshtë:)*

______________________________________________________________

______________________________________________________________

Bashkëlidhur argumentet e vendimmarrjes dhe mendimi i pakicës i paraqitur në procesverbalin e mbledhjes se komisionit.

Klea Topa ____________________ **Kryetar i komisionit**

*(emri, mbiemri, firma)*

Brunelda Gora ____________________ **Sekretar i komisionit**

*(emri, mbiemri, firma)*

Datë: 26.08 2025